



Në bazë të autorizimeve të dhëna me nenin 10.3, të Ligjit nr. 03/L-072 për Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës dhe nenin 37.2 nën paragrafi (c) të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, më 00.02.2018, nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **ZNJ. DANIJELA VUJIČIČ** emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Mitrovicën e Veriut, nga subjekti politik "SRPSKA LISTA" duke e zëvendësuar anëtares e Kuvendit Komunal znj. Dušica Gusnič-Djinovič
- II. Obligohet Sekretariati i KQZ-së, që ky vendim t'i komunikohet znj. Danijela Vujičić, dhe të ndërmerren veprimet procedurale për zbatimin e tij.

### Arsyetim

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve pas shqyrtimit të shkresave të lëndës të dorëzuara në KQZ më datën 23.02.2018, nr.225/2018, për zëvendësimin e anëtares së Kuvendit znj. Dušica Gusnič-Djinovič, pas dorëheqjes së saj të parevokueshme nga pozita e anëtares së Kuvendit të Komunës për arsye personale.

Andaj, duke u bazuar në deklaratën e pranimit të mandatit të kandidatës së radhës sipas listës së rënditur, e cila është, znj. Danijela Vujičić nga i njëjti subjekt politik, i gjinisë së njëjtë dhe me numër më të madh të votave, sipas rezultateve të certifikuar të zgjedhjeve lokale të vitit 2017, dhe pas plotësimit të të gjitha kushteve ligjore, KQZ-ja vendosi si në pikën I të këtij vendimi.

- III. Ky vendim, hyn në fuqi ditën e nënshkrimit të tij.

Prishtinë, 00.02.2018

Kryetare e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

Valdete Daka